



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

**Kryetarja e Komunës**

**01nr \_\_\_\_\_**

**Dt: 16.04.2015**

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve dhe Përfundimit nr.06-23138-13/2 të miratuar me dt: 25.03.2015 në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, me të cilin është miratuar kërkesa e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së – dega në Gjakovë për ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve operative të kësaj shoqate, me dt: 16.04.2015 e miraton këtë:

**V E N D I M**

**I.** Miratohet kërkesa e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së – dega në Gjakovë, e evidentuar me nr. 01-400-13051 e dt: 12.02.2015, për mbështetje financiare të kësaj shoqate për mbarëvajtjen dhe për mbulimin e shpenzimeve operative për periodën një vjeçare, duke e mbështetur me subvencione të Zyrës së Kryetares së Komunës në vlerë prej 3,050.00€.

**II.** Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 3,050.00€ nga mjetet e subvencioneve të Zyrës së Kryetares së Komunës dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhironlogarinë e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së – dega në Gjakovë, nr. 1704-0010-110190.36 NLB Bank.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**IV.** Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Zyrës së Kryetares së Komunës
- Z. Maxhun Shala, kryetar i Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së – dega në Gjakovë
- Arkivit

**Kryetarja e Komunës,**

**Znj. Mimoza Kusari-Lila**